



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:004800

Datë: 11.01.2024

Numri i dokumentit: 05178011

PPP. nr.1692/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fatbardha Uka Ibrahim, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KPMM, me seli në P., kundër debitorit H.H., nga P., rr., të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Klinaku”, lidhur me çështjen përmbarimore, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhrit përmbarimor P.nr.917/21, të datës 20.05.2021, të lejuar nga përmbaruesi privat Atip Mustafa, për territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 10.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZHET në tërësi** prapësimi i debitorit H.H., nga P., i paraqitur kundër urdhrit përmbarimor P.nr. 917/21 të datës 20.05.2021, si i pabazuar.
- II. MBETET NË FUQI** urdhri përmbarimor P.nr.917/21, i datës 20.05.2021, lejuar nga përmbaruesi privat Atip Mustafa, për territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

A r s y e t i m

Kreditorit KPMM, me datë 20.05.2021, ka parashtruar propozimin për përmbarim, kundër debitorit H.H. nga P., në bazë të aktvendimit të KPMM me nr. 3605 të datës 22.11.2014, i ekzekutueshëm nga data 13.05.2021, për pagesën e gjobës administrative në shumë prej 5,000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi privat, Atip Mustafa, si organ përmbarues, përmes urdhërit përmbarimor P.nr. 917/21 të datës 20.05.2021, ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori.

Kundër këtij urdhri përmbartimor, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim pranë kësaj gjykate, ashtu që ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se vendimi i lëshuar nuk është i përshtatshëm për përmbartim, ashtu siç parashihet me nenin 27 të LPP-së dhe si i tillë ky vendim nuk është dokument përmbartues sipas nenit 21 dhe 22 të LPP-së, ngase sipas kësaj dispozite ligjore, përcaktohen saktë se cilat janë dokumentet përmbartuese. Ka shtuar se i njëjti është i kundërligjshëm sepse debitori asnjëherë nuk e ka pranuar vendimin nga komisioni i pavarur për miniera dhe minerale dhe nuk ka pasur mundësinë e ushtrimit të ankesës ndaj këtij vendimi mbi të cilin është lejuar përmbartimi. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit H.H., nga P., dhe urdhri për përmbartim i dhënë në bazë të propozimit të kreditorit, të ndalohet në tërësi dhe të anulohen të gjitha veprimet e kryera.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se nuk qëndron pretendimi i debitorit se dokumenti përmbartues nuk plotëson kushtet e dokumentit përmbartues pasi akti administrativ është akt i lëshuar në procedurën administrative sipas Ligjit për Procedurën Administrative, duke shtuar se LPP në nenin 22 par. 1.2., përcakton se dokumenti përmbartues është vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi. Ka shtuar se debitori me qëllim të shmangies së pagesës së gjobës nuk ka pranuar aktin e dërguar dhe i njëjti është kthyer një herë më datë 14.09.2017 dhe pastaj edhe me datë 02.07.2018, andaj në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka bërë dorëzimin e shkresës me anë të shpalljes publike. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr. 917/21 dhe njëherit të obligohet debitori në shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar, nga këto arsye:

Sipas aktvendimit të KPMM Nr. 3605 të datës 22.11.2014, i plotëfuqishëm nga data 27.04.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 13.05.2021, gjykata gjeti se debitori i ishte shqiptuar gjobë administrative për hulumtimin e mineraleve tufë me piroklastite andezite, pa posedimin e licencës për hulumtime, në shumë prej 5,000.00 €.

Nga aktvendimi me nr. 1027 të datës 16.03.2021, gjykata gjeti se pas tentimit për dorëzim të aktit administrativ në përputhje me nenin 7 par. 3 i Udhëzimit Administrativ me nr. 001/2018, nga fletëkthesa e kthyer nga posta dy herë, është konstatuar se pala nuk ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13, është bërë shpallja publike e aktit administrativ nr. 3605 të datës 22.12.2014.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e nenit 21 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore ku parashihet që *“organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Në rastin konkret kreditori ka kërkuar lejimin e propozimit për përmbartim për borxh në shumë prej 5,000.00 euro, sipas dokumentit përmbartimor – Aktvendimit të KPMM, me numër 3605 të datës 22.12.2014, i plotëfuqishëm me datë 27.04.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 13.05.2021.

Ndërsa në bazë të nenit 22 par. 1 i LPP-së, ky aktvendim ka titull përmbarues, ku përcaktohet se: *“Dokumentet përmbaruese janë: 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi”*, dhe ky vendim është i përmbarueshëm në bazë të nenit 24 par 3 të LPP-së, ku theksohet se *“ vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë ”*, dhe njëkohësisht është edhe i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të nenit 27 par.1 të LPP-së, ku thuhet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Andaj, gjykata ka vlerësuar se ky aktvendim i plotëson të gjitha kushtet e lartcekura ligjore për tu caktuar dhe zbatuar përmbarimi sipas tij.

Gjykata analizoi edhe pretendimet e debitorit, i cili ka theksuar se nuk e ka pranuar aktvendimin e kreditorit. Gjykata konstaton se pretendimet e tilla janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës sepse sipas legjislacionit në fuqi, dërgimi i shkresës është bërë në mënyrë të rregullt, kjo konform nenit 122 par.1 të Ligjit për Procedurën Administrative. Për më tepër, gjykata në procedurë përmbarimore bazohet vetëm në aktvendimin administrativ të potencuar i cili paraqet titull ekzekutiv.

Nga ajo që u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22 par.1 nënpar.1.2, neni 23 par.2, 24 par.3, neni 27 par.1, neni 71, 73 dhe neni 77 par.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.1692/21, datë 10.01.2024

Gj y q t a r j a
Fatbardha Uka Ibrahim

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.